

Në bazë të dispozitave të nenit 11, nenit 12.2 shkronja c) dhe nenit 17 shkronja s) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), Udhëzimit Administrativ të MAPL 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit komunal, nenit 32.2 të Statutit të 01. Nr. 06 - 103/1 dt.11.09.2008, Kuvendi Komunës së Dragashit, në mbledhjen e mbajtur me **14.12.2016**, miratoi:

## **R R E G U L L O R Ë N**

### **E PUNËS SË KUVENDIT KOMUNAL DRAGASH**

#### **Neni 1.** **Qëllimi**

Me këtë Rregullore përcaktohet puna e funksionimit të seancave të Kuvendit komunal në Dragash, procedura e konvokimit, diskutimet, e drejta dhe mënyra e votimit.

#### **Neni 2.** **Fushëveprimtaria**

Kuvendi do të shqyrtoj vetëm ato çështje të cilat i përkasin fushëveprimit të tij, pos nëse ato ndryshohen me kërkesë të institucioneve qendrore të Republikës së Kosovës.

#### **Neni 3.** **Përkufizimet**

- "**Kuvendi i Komunës**" – është organi ma i lart i komunës që përbëhet prej anëtarëve të tij të zgjedhur,

- "**Komunë**" – do të thotë njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Kosovë e përberë nga qytetarët e komuniteteve në një territor të caktuar të përcaktuar me Ligj,

- "**Kryetari**" - është organi ma i lartë ekzekutiv i komunës që zgjedhet përmes zgjedhjeve të drejtpërsëdrejta.

- "**Komunitet**" – do të thotë grup komuniteti që i përkasin një grupi të njëjtë etnik, fetar apo gjuhësor.

- "**Vetëqeverisja lokale**" – do të thotë e drejta dhe aftësia e autoriteteve lokale të themeluara sipas Ligjit dhe në kuadër të kufizimeve të tij që të rregullojnë dhe menaxhojnë njs pjesë substanciale të çështjeve publike nënë përgjegjësin e tyre dhe në interes të popullatës vendore,

- "**Votimi i shumicës**" (**kuorumi**) – do të thotë votim për të cilin kërkohet miratimi i ma shumë se gjysmës së anëtarëve të pranishëm dhe votim në takimin në të cilin shqyrtohet propozimi,

- "**Shumica prej dytë tretave (2/3)**" do të thotë votimi që kërkon miratimin e 2/3 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

-**“Rregullore komunale”** – akti juridik që miratohet nga numri i kërkuar i anëtarëve të Kuvendit të Komunës që rregullon një lëmi të caktuar të kompetencave të Komunës.

#### **Neni 4.**

#### **Mbledhjet inauguroese, të rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit komunal**

Mbledhjet Kuvendi Komunal thirren dhe mbahen ashtu si që është përcaktuar me nenin 42. 43. 44. Të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 36. Të Statutit të Komunës dhe Udhëzimit Administrativ të MAPL 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit.

#### **Neni 5.**

#### **Caktimi i rendit të ditës**

Për mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës, rendi i ditës caktohet nga Kryesuesi i Kuvendit në marrëveshje me Kryetarin e komunës dhe Kryesuesin

#### **Neni 6.**

#### **Mbledhjet e jashtëzakonshme**

1.Mbledhjet e jashtëzakonshme të KK-së caktohen sipas nevojës së arsyeshme me kërkesë të bërë me shkrim nga Kryetari i Komunës dhe nga ma së paku 1/3 së anëtarëve të KK-sël, dhe atë së paku 3. ditë pune para mbledhjes.

1.1.Kryesuesi i Kuvendit të Komunës është i obliguar të thërret mbledhje të jashtëzakonshme sipas kërkesës së një të tretës (1/3)së anëtarëve të Kuvendit Komunal, apo kërkesës të Kryetarit të Komunës.

1.2. Rendi i ditës i paraparë për mbledhjen e jashtëzakonshme nuk mundë të ndryshohet e as të plotësohet.

#### **Neni 7.**

#### **Pjesëmarrja e publikut dhe njoftimet për mbledhje**

1.Mbledhjet e Kuvendit Komunal janë të hapura për publikun, pos nëse nuk vendoset ndryshe nga anëtarët e Kuvendit

2.Njoftimet paraprake me shkrim, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, bëhen 7. ditë pune para mbajtjes së tyre. Njoftimi bëhet në ueb-faqen zyrtare të komunës, tabelën e shpalljeve në komunë dhe mjeteve të informimit publik

3.Njoftimet duhet të përmbajnë:

3.1 datën e mbajtjes,

3.2.kohën e mbajtjes,

3.3.vendin e mbajtjes dhe

3.4. rendin e ditës me materialet shtesë të mbledhjeve, nëse ka.

2.2.Njoftimi u dërgohet edhe Ministrisë të Pushtetit Lokal , si dhe mediave elektronike të cilat kanë kontrata me KK-së, për përcjelljen e punës së organeve komunale.



## **Neni 8.**

### **Pjesëmarrja në mbledhje**

1. Çdo anëtar i cili merr pjesë në takim - mbledhje të Kuvendit nënshkruhet në listën e të pranishmëve të dizajnuar për këtë çështje e që shërben për caktimin e kuorumit dhe si bazë për kompensimin material të tyre, sipas Rregullores e cila rregullon kompensimin.

1.1. Anëtarët e nënshkruar në Listën e të pranishmëve, janë të obliguar të qëndrojnë deri në fund të mbledhjes, përpos nevojave të largimit në raste të arsyeshme ku duhet të i lajmrohet Kryesuesit – administratës së Kuvendit.

## **Neni 9.**

### **Procesverbali**

1. Për mbledhjet e Kuvendit mbahet Procesverbali ( i cili përmban esencën e diskutimit dhe votimin , ndërsa miratohet në mbledhjen e radhës, në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.

1.1. Për paraqitjen e propozimeve , apo arsyetimeve nga ana e përfaqësuesve të opinionit në mbledhje, vendos Kryesuesi i mbledhjes i cili ka edhe të drejtën e ndërprerjes së diskutimit.

## **Neni 10.**

### **Rregullat e diskutimit**

1. Ecuria e mbledhjes fillon sipas rendit paraprak të ditës, pos nëse para aprovimit të tij vendoset ndryshe nga këshilltarët, me shumicë votash.

1.1. Për marrjen e fjalës, në mënyrë të barabartë dhe sipas radhës së paraqitjes, vendos Kryesuesi i mbledhjes, kurse diskutimet zgjasin deri në 10. minuta, me përjashtim të referuesve dhe Kryetarit të Komunës.

1.2. Sqarimet apo replikat eventuale nuk mund të zgjasin më shumë se 2. Minuta

1.3. Askush nuk ka të drejtë diskutimi, ma tepër se një herë, për të njëjtën çështje.

2. Subjektet politike caktojnë udhëheqësit e grupit të tyre, që japin propozime në emër të subjektit që e përfaqësojnë, përfshirë edhe të drejtën e kërimit të pauzës konsultative, për të cilën përcaktohet Kryesuesi i mbledhjes.

## **Neni 11.**

### **Kuorumi dhe votimi**

1. Para fillimit të çdo mbledhje duhet të konstatohet kuorumi, që është më shumë se gjysma e numrit të anëtarëve prezent, nga numri i tërësishëm i anëtarëve të Kuvendit Komunal.

2. Votimi në të gjitha mbledhjet bëhet me vota të hapëta, pos për rastet kur me Ligjin për vetëqeverisje Lokale dhe Statut të komunës kërkohet votimi i fshehtë.

2.1. Para votimit për vendimin e marr nga Kryesuesi, konstatohet kuorumin dhe numri i votave, pas votimit.

3. Çdo anëtar i Kuvendit ka një votë por Kryesuesi ka një votë shtesë, nëse votimi është i barabartë për ose kundër një propozimi.

4. Abstenimi i ndonjë anëtari regjistrohët, por nuk merret parasysh në rezultatet e votimit.

**Neni 12.**  
**Konflikti i interesit**

Nëse për ndonjë çështje ka supozime të bazuara apo të verifikuara të konfliktit të interesit të ndonjë anëtari ,ose referuesit, nga Kryesuesi kërkohet përjashtimi i tij/saj nga diskutimi dhe votimi.

**Neni 13.**  
**Sjelljet e anëtarëve dhe publikut**

1.Nëse Kryesuesi i mbledhjes konsideron se ndonjëri nga anëtarët ka sjellje jo të mirë në mbledhje, duke mos respektuar qëllimisht , rrjedha dhe puna e mbledhjes, në mënyrë ofenduese apo mënyrë tjetër të papranueshme , atij/asaj duhet ti tërhiqe vërejtja.

1.1. Nëse anëtari edhe pas vërejtjes së dhënë vazhdon me sjelljen e tillë nga Kryesuesi propozohet që mos të dëgjohet nga anëtarët tjerë dhe nëse edhe pas kësaj vazhdon me sjellje jo të mirë ,anëtarit të tillë i ndalohet fjalimi, përfshirë edhe kërkimin që të largohet nga mbledhja, përveç kur është në pyetje votimi.

1.2.Masa e fundit për evitimin e sjelljeve jo të mira në mbledhje është ndërprerja e mbledhje e përkohshme , me caktimin e orës apo datës së vazhdimit të saj. Për sjellje jo të mira , e njëjta procedurë vlen edhe për pjesëmarrësit e publiku në mbledhjet e Kuvendit.

**Neni 14.**  
**Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja 01.Nr.06-52/2 Dt.21.07.2010 e Punës së Kuvendit Komunal dhe organeve të tij.


**Neni 15.**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hynë në fuqi 15.ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal në Prishtinë, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare, në ueb-faqen zyrtare të komunës.

01.Nr.06-22263/1

Dt.14.12.2016

**D r a g a s h**

**KUVENDI KOMUNAL DRAGASH,**  
Kryesuesi  
  
**Shaban Shabani**

